



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 112 Datë 22.11.2018

SHQYRTIM RAPORTI AUDITIMI

Autoriteti kontraktor	Bashkia Kolonjë (ish Bashkia Leskovik)
Organi auditues	KLSH
Numri i procedurave të audituara	10
Lloji i procedurës/ave të audituara	Procedurë e hapur dhe Kërkesë për propozim.
Konstatimet kryesore	Nga shqyrtimi i raportit dhe i gjithë informacionit të administruar, Agjencia e Prokurimit Publik konstatoi se, në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga Bashkia Kolonjë, si dhe në një procedurë të zhvilluar nga ish Bashkia Leskovik, nuk janë dokumentuar çmimet e përdorura në përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 28 të Ligjit të Prokurimit Publik. Në një procedurë të zhvilluar nga Bashkia Kolonjë, nuk është argumentuar dhe dokumentuar përdorimi i procedurës për “Kontrata publike furnizimi”, ndërkohë, në preventiv është një ndërthurje ndërmjet mallrave të ndryshëm dhe zërave të punës. Lidhur me procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, ka rezultuar se, autoriteti kontraktor ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorët ekonomikë, në kundërshtim me kërkesat e kualifikimit dhe me nenet 53, pika 3, dhe 55, pika 2, të Ligjit të Prokurimit Publik, në shtatë procedura prokurimi, të zhvilluara nga Bashkia Kolonjë.

Masat e marra	1. APP, në bazë të nenit 72, pika 1 të Ligjit të Prokurimit Publik, ka dënuar me gjobë 15 (pesëmbëdhjetë) persona, në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës për përlogaritjen e fondit limit, anëtarëve të komisionit të shqyrtimit të ankesave dhe anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. 2. APP, në bazë të nenit 72, pika 2, të Ligjit të Prokurimit Publik, ka propozuar për marrjen e masës disiplinore për 2 (dy) persona.
----------------------	--